



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2022:105924

Datë: 02.04.2025

Numri i dokumentit: 07075803

C.nr.779/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjyqtari Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.K.nga fshati D. Komuna e P. të cilin e përfaqëson Agim Shala avokat në Pejë, kundër të paditurit M. (Zh.) B. nga fshati D. Komuna e P. tani me vendqëndrim të panjohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Veton Berisha avokat në Pejë, me objekt kontesti *vërtetim i së drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit prej 5,000.00€, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor publik, me datë 27.03.2025, mori dhe ndërsa me date 02.04.2025 përpiloi këtë:*

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET NË TËRËSI kërkesëpadia e paditësit B.K.nga fshati D. Komuna e P., SI E BAZUAR.
- II. VËRTETOHET se paditësi BK.nga fshati D. Komuna e P. ka të drejtën e pronësisë në bazë të mbajtjes me mirëbesim të ngastrës kadastrale P-71611025-00031-0 me sipërfaqe prej 6588 m<sup>2</sup> ZK D. dhe DETYROHET i padituri M. (Zh.) B. që paditësit t'ia pranoj të drejtën e pronësisë në ngastrën kadastrale të përshkruar në pikën II të këtij dispozitivi dhe të lejoj që i njëjti të regjistrohet si pronar i ngastrës në fjalë në Zyrën Kadastrale në Komunën e P., në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjyqimit e nën kërcënim të përmbarimit.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A R S Y E T I M

## I. Historiku i procedurës

Paditësi B. Kastrati, në gjykatën e titullit, me datën 25.05.2020, kundër të paditurit M. (Zh.) B., ka ngritur padi me bazë juridike vërtetim i së drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 5,000 euro.

Gjykata ka tentuar komunikimin me të paditurin, mirëpo nuk ka mundur që të bie në kontakt me të njëjtin, e me qëllim të plotësimit të kushteve procedurale të njëjtit i ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm, avokatin Veton Berisha, nga Peja.

## II. Pretendimet e ndërgjyqësve

Paditësi ka paraqitur padi për vërtetimin e së drejtës së pronësisë kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se ai është pronar i patundshmërisë së evidentuar në librat kadastrale si ngastra me numër P. nr. 031/0, me sipërfaqe prej 6588 m<sup>2</sup>, Z.K. D., dhe të detyrohet i padituri që t'ia njohë të drejtën e pronësisë mbi këtë patundshmëri dhe të lejojë regjistrimin e paditësit si pronar në Zyrën Kadastrale përkatëse. Gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, paditësi ka qëndruar në tërësi pranë padisë dhe ka kërkuar që gjykata t'ia njohë të drejtën e pronësisë mbi pronën e blerë prej tij. Ka shtuar se në vitin 1986, nga i padituri e ka blerë patundshmërinë që është objekt i kontestit dhe që nga ajo periudhë ka hyrë në posedim të lirë dhe të qetë të kësaj prone, të cilën e ka shfrytëzuar pa asnjë pengesë juridike apo faktike, qoftë nga i padituri apo nga ndonjë person i tretë. Po ashtu, ka deklaruar se bartja e pronës në emrin e tij nuk ka qenë e mundur për shkak të ndalimeve ligjore të kohës, sipas të cilave shitblerja e patundshmërive ndërmjet nacionaliteteve të ndryshme, veçanërisht kur blerës ishin shqiptarë, ishte e ndaluar. Meqenëse tashmë ka kaluar një periudhë e gjatë kohore dhe ai e ka shfrytëzuar pronën në mënyrë të vazhdueshme dhe të pakontestuar, ai pretendon se ka fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e kushteve të përcaktuara me LMTHPJ. Tutje ka deklaruar se paditësi e ka përmbushur çmimin kontraktual në shumën prej 2.903.500,00 dinarë të rinj të atëhershëm, gjë që vërtetohet me kontratën e nënshkruar nga palët dhe dëshmitarët më 30.01.1986, si dhe me procesverbalin e firmosur nga të dyja palët, ku vërtetohet se shitja është bërë me dëshirë të lirë dhe pa asnjë presion. Për më tepër, ekzistojnë edhe dy fatura të dorëshkuara të datave 02.02.1986 dhe 03.03.1986, të cilat dëshmojnë pagesën e plotë të çmimit të kontraktuar. Përfundimisht, ka propozuar që gjykata ta aprovojë kërkesëpadinë dhe t'ia njohë të drejtën e pronësisë mbi patundshmërinë e kontestuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i përkohshëm, me përgjigjen në padi, gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke e konsideruar të pabazuar për shkak të mungesës së argumenteve dhe provave materiale. Megjithatë, duke mos pasur kontakte me të paditurin, përfaqësuesi ka deklaruar se nuk mund të marrë një qëndrim më të detajuar mbi pretendimet e palës paditëse. Gjatë seancave gjyqësore, përfaqësuesi i përkohshëm ka theksuar se paditësi pretendon të ketë blerë pronën në vitin 1986 dhe e ka poseduar në mënyrë të lirë dhe të papenguar që nga ajo kohë. Për shkak të mungesës së autorizimit të drejtpërdrejtë nga i padituri, përfaqësuesi e ka lënë çështjen në vlerësimin e gjykatës.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, përfaqësuesi ka kërkuar kompensimin e tyre për përfaqësues të përkohshëm.

#### IV. Provat e administruara nga gjykata

Gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike, sipas propozimit të palëve, në procedurën e të provuarit, i ka administruar këto prova: Certifikata e pronës e datës 10.05.2022, kontrata në dorëshkrim e datës 30.1.1986 në mes të B.K.dhe M. B., procesverbali i datës 30.1.1986, dëftesa e datës 02.02.1986 dhe 03.06.1986, përgjigja nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës e datës 13.11.2024 me numër 01705/24/hj, ekspertiza gjeodezike e datës 21.1.2025 së bashku me certifikatën e pronës, fotografitë e vendit të ngjarjes dhe skica e identifikimit e përpilur nga eksperti P.T., si dhe dëgjimin e dëshmitarëve, A.K.dhe S.S..

#### IV. Vlerësimi faktik dhe juridik i gjykatës

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nuk ishte kontestues fakti se pala e paditur në regjistrat kadastral evidentohet si pronare e ngastrës kadastrale me numër P-71611025-00031-0 me sipërfaqe prej 6588 m<sup>2</sup> ZK D., fakt ky i vërtetuar edhe përmes certifikatës së pronës të datës 10.05.2022.

Kontestuese ishte fakti, nëse palës paditëse i takon e drejta e pronësisë në ngastrën kontestuese.

Përmes përgjigjes nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, e datës 13 nëntor 2024, Nr. ref.: 01705/24/hj, gjykata ka vërtetuar faktin se, bazuar në të dhënat e disponueshme, nuk është identifikuar ndonjë kërkesë të parashtruar nga B. M., ose ndonjë person tjetër, lidhur me ngastrën kadastrale nr. 31-0 ZK Doberdol, Komuna e P.. Agjencia ka konfirmuar se, pas shqyrtimit të dokumenteve dhe bazës së të dhënave, nuk ka pasur asnjë kërkesë për këtë pronë, si dhe nuk ka asnjë informacion për një person të përgjegjshëm që mund të jetë paraqitur në Drejtorinë ose AKP-në përkatëse. Kësaj prove, gjykata i fali besimin, pasi që e njëjta është e lëshuar nga një Agjencion i pavarur dhe kompetent për çështjet pronësore, ku bazuar në Ligjin nr.05/L-010, Agjencia është përgjegjëse për pranimin, krahasimin dhe zgjidhjen e dallimeve dhe mos pajtueshmërisë në mes të dokumenteve kadastrale origjinale, para qershorit 1999 e të cilat janë të marra nga autoritetet sere dhe dokumenteve aktuale në Republikën e Kosovës, në lidhje me pronën private, private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar ekspertizën e gjeodetit P.T., të nxjerrë në procedurën kontestimore, të cilës nuk i kanë bërë vërejtje asnjëra palë. Përmes kësaj ekspertize, gjykata vërtetoi faktin se parcela kadastrale nr. 31-0 (5-6588m<sup>2</sup>) është e regjistruar në Z.K. D. dhe figuron në pronësi të M. Zh. B. 1/1. Parcela kufizohet me prona të ndryshme, duke përfshirë tokën në pronësi të familjes B. në veri, pronën e B. Kastratit në lindje dhe jug, si dhe rrugën në perëndim e cila është prone shoqërore. Më 21.01.2025, gjatë verifikimit në terren, u konstatua se parcela ishte tokë e punuar dhe e mbjellë me grurë. Në anën perëndimore ndodhej një rrugë kadastrale e paasfaltuar që lidhej me rrugën kryesore dhe ishte e rrethuar me hunj dhe tela. Në veri ekzistonte një rrugë faktike, e paregjistruar në kadastër, e cila shërbente për parcelat fqinje. Parcela ishte e rrethuar me hunj druri dhe tela, ndërsa në lindje dhe jug kufizohej me tokën e punueshme në pronësi të paditësit, i cili e punonte atë vetë. Në bazë të këtyre fakteve, ekspertiza vërtetoi kufizimet dhe gjendjen faktike të pronës, duke konfirmuar përdorimin dhe karakteristikat e saj në momentin e verifikimit. Ekspertiza për më tepër ka në përmbajtje edhe certifikatën e pronës për ngastrën lëndore, ortofotn e kësaj ngastre si dhe fotografitë e vendit të ngjarjes.

Gjykata, kishte ftuar në sqarim ekspertin gjeodet, pavarësisht faktit se asnjë nga palët nuk kishte vërejtje në ekspertizën e tij, i cili në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.03.2025, kishte deklaruar se qëndroj në tërësi pranë ekspertizës gjeodezike të datës 21.01.2025 dhe kishte

deklaruar se nuk kam asgjë më shumë për të shtuar rreth kësaj ekspertize, kurse asnjë nga palët nuk kishte pyetje e as vërejtje në deklarinimin e të njëjtit.

Me daljen në vendshiqim së bashku me ekspertin e gjeodezisë si dhe palët në procedurë, përveç nxjerrjes së provës me ekspertizë, gjykata ka bërë edhe vend shikimin, me ç'rast ka konstatuar se pala paditëse në ngastrën kadastrale ka të mbjellë grurë. Konstatimet e tjera të cilat i ka bërë gjykata në teren, janë po ato të cilat i ka prezantuar eksperti me ekspertizën e tij gjeodezike, të cilat kanë përputhje të plotë. Palët në procedurë, i autorizuari i paditësit si dhe përfaqësuesi i përkohshëm, nuk kishin bërë vërejtje në konstatimin e gjendjes faktike në teren, të cilën e kishte konstatuar gjykata me ndihmën e ekspertit gjeodetP.T..

Gjykata, me propozimin e të autorizuarve të palës paditëse, ka bërë dëgjimin e dëshmitarëve Ali Kastrati dhe S. S.jaj në seancën e datës 27.03.2025, ku Ali Kastrati, pasi që ishte njoftuar me të drejtat e tij nga neni 247 dhe 343 të LPK-së, ka deklaruar se: nuk ka qenë prezent gjatë aktit të shitblerjes, por është në dijeni se Bahimi ka blerë një pronë nga M. B. në fshatin D., në vendin e quajtur B., që ndodhet në lug. Ai nuk e di sipërfaqen e saktë të pronës, por pohon se e ka punuar dhe kositur vetë atë tokë. Sipas tij, blerja është realizuar në vitin 1986 ose 1987 ku për këtë shitbjerje paditesi kihte kthyer një darke për blerjen e kësaj toke, ku edhe ai ka qenë i pranishëm. Çmimi ka qenë rreth 300-400 marka për një ari. Dëshmitari ka theksuar se Bahimi ka filluar ta punojë pronën menjëherë pas blerjes dhe e punon edhe sot. Gjithashtu, ka shtuar se nuk ka dëgjuar që Bahimi të ketë pasur ndonjë problem lidhur me këtë pronë dhe se pranë saj ai ka edhe disa prona të tjera të ngjitura me këtë parcelë.

Dëshmitari S. S.. në dëshminë e tij në seancën e datës 27.03.2025, ka deklaruar se: B.i ka blerë një tokë nga M. B. më shumë se 40 vjet më parë, e cila ndodhet në fshatin D., në vendin e quajtur Lug. Sipas tij, kjo parcelë është e rrethuar nga pronat e B.it në të dy anët dhe ka një rrugë në ballë. Ai ka deklaruar se nuk ka qenë i pranishëm gjatë aktit të shitblerjes, por ka marrë pjesë në një darkë që është organizuar atë natë nga B.i. Sipas asaj që ka dëgjuar, çmimi për një ari ka qenë rreth 430-440 marka dhe të gjitha paratë janë paguar, ndërsa pas pranimit të tyre, palët janë larguar. Dëshmitari ka deklaruar se B.i e ka punuar këtë tokë vazhdimisht që nga momenti i blerjes deri më sot dhe asnjëherë nuk është penguar nga askush. Ai ka deklaruar gjithashtu se fshati D. e njeh këtë pronë si tokën e B.it. Sa i përket sipërfaqes, dëshmitari ka cekur se nuk e di me saktësi, por mund të jetë mbi 1 (Nje) hektar.

Deklaratave të dëshmitarëve, gjykata u ka falur besim të plotë, pasi deklaratat e tyre përputheshin me gjendjen faktike, si dhe për faktin se njëri nga ta, A., ishte banor i vendit ku gjendej ngastra lëndore, ndërsa tjetri, S.ja, ishte me prejardhje nga fshati D. dhe posedonte prona atje, ku vizitonte shpesh. Ata kishin njohuri të gjera lidhur me çështjen kontestuese, përfshirë vendin e ngastrës, çmimin, periudhën dhe mënyrën e blerjes, dhe ishin dëshmitarë okularë gjatë një zijafteti (ahengu) të organizuar nga paditësi për këtë shitblerje.

Në kuptim të të thënave më lartë, Gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë çështje juridike - kontestimore duhet të zbatohen dispozitat e ligjit material të *Ligjit Mbi Mardhëniet Themelore Juridiko Pronësore Nr. 827 dt.30.01.1980*, për shkak se raporti i i krijuar është i vitit 1986, andaj edhe aplikohen dispozitat materiale që kanë qenë në fuqi.

Paditësi, në këtë çështje, ishin thirrur në bazën juridike të shitblerjes, gjykatës iu ofruan kontrata dhe dëshmi të ndryshme, përfshirë kontratën në dorëshkrim të datës 30.01.1986, të nënshkruar ndërmjet B. K. dhe M. B., procesverbalin e datës 30.01.1986, si dhe dëftesat e pagesës të datave 02.02.1986 dhe 03.06.1986. Megjithatë, gjykata nuk ka mundur t'u falë besim këtyre dokumenteve, sepse ato ishin të shkruara me dorëshkrim dhe nuk ishin verifikuar nga organet kompetente për të siguruar autenticitetin e tyre. Kjo ka ndikuar në besueshmërinë e dokumenteve dhe ka bërë që gjykata të mos i pranojë si prova të besueshme në këtë rast. Sipas nenit 20 të këtij Ligji, *e drejta e pronësisë fitohet në bazë të veprimit juridik, sipas vetë ligjit dhe me trashëgim, e po ashtu edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe mënyrën e caktuar me ligj.* Më tutje, në nenin 33, theksohet se *“Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj.”* Përmes kësaj kuptohet se paditësi, pretendimin e tij të cilin e mbështetnin në një punë juridike, pra në kontratë, e mbi të cilën pretendonte se e kishin fituar të drejtën e pronësisë, është i pabazuar, sepse në mënyrë që një gjë e tillë të kishte efekt juridik, është e domosdoshme që të ekzistojë puna juridike (kontrata formale) dhe e njëjta të jetë e regjistruar në regjistrat publik. Pra kërkohen dy kushtet të plotësohen në mënyrë kumulative. Mbi një bazë të tillë, palës paditëse nuk i derivon e drejta e pronësisë.

Duke u bazuar në nenin 2.2 të LPK-së, *“Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”.* Me këtë rast, gjykata konstaton se sipas LMTHPJ-së, nenit 28 par.4, me të cilën është saktësuar çështja e parashkrimit fitues, theksohet se, *“Mbajtësi me mirëbesim i sendit të*

*paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh*”. Nga ajo që u elaborua më lartë, gjykata konstaton se në rastin konkret, janë plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara nga dispozita e mësipërme, të cilat janë: *sendi të jetë i paluajtshëm, posedimi të jetë me mirëbesim dhe të kalojë koha e paraparë sipas ligjit*.

Me këtë rast, gjykata konstaton se sipas LMTHPJ-së, nenit 28 par.4, me të cilën është saktësuar çështja e parashkrimit fitues, theksohet se, *“Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh*”. Nga ajo që u elaborua më lartë, gjykata konstaton se në rastin konkret, janë plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara nga dispozita e mësipërme, të cilat janë: *sendi të jetë i paluajtshëm, posedimi të jetë me mirëbesim dhe të kalojë koha e paraparë sipas ligjit*. Sa i përket kushtit të parë, nuk është fare kontestuese se paluajtshmëria kontestuese është send i paluajtshëm dhe se e njëjta e regjistruar në regjistrat kadastral e mbi të cilën mund të vendosen të drejta dhe detyrime si dhe e njëjta është pronë private, e transferueshme e mbi të cilën mund të aplikohen dispozitat e parashkrimit fitues, e kjo e provuar dhe me certifikatën e pronës, sipas të cilës e paditura evidentohet si pronar.

Lidhur me çështjen e mirëbesimit, gjykata thekson se në këtë rast, sipas dispozitave ligjore, mirëbesimi është fakt që prezumohet, por përveç kësaj, një gjë e tillë nuk është kontestuar as nga pala e paditur. Për më tepër, çështje me rëndësi tek mirëbesimi është fakti nëse poseduesi ka vepruar në raport me paluajtshmërinë sikur ai të jetë pronari. Në këtë rast, pala paditëse, në ngastrën kontestuese kishte të punuar, ashtu që për gjykatën ka mjaftuar për të provuar faktin se i njëjti pronën në fjalë e ka trajtuar si të vetën, e ka punuar në vazhdimisht që nga viti kur e ka blerë, pra nga viti 1986 e të cilën e shfrytëzon që nga koha kur ka hyrë në posedim të kësaj ngastre kontestuese. Për më tepër, pavarësisht se mirëbesimi është fakt që prezumohet përderisa nuk vërtetohet e kundërta, ai u provua dhe me dëshmitë e dëshmitarëve, të cilët pohuan se paditësit, ishin në posedim në mënyrë të pashkëputur në këtë ngastër, që nga koha kur e njëjta ishte blerë nga paditësi në vitin 1986, e pandërprerë.

Kriteri apo kushti i tretë i posedimit, e që është koha e kaluar e kërkuar sipas ligjit, që në këtë rast është afati 20 vjeçar e i cili duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i pandërprerë, ku si kohë e rrjedhjes së këtij afati na paraqitet dita kur poseduesi është futur në posedim (vitet e 86-ta dhe përfundon me kalimin e ditës së fundit të kohës së nevojshme për parashkrim fitues (që ka qenë vitet e 2006- ta ), e paraparë sipas nenit 30 par.1 të LMTHJP-së *“Koha e nevojshme për parashkrimin fitues fillon të ecë nga ajo ditë*

kur mbajtësi ka marrë në posedim sendin dhe mbaron me kalimin e ditës së fundit të kohës së nevojshme për parashkrimin fitues”, por pavarësisht kësaj, i njëjti e ka vazhduar dhe më tutje posedimin, kur një fakt i tillë u provua me anë të dëshmitarëve, me daljen e gjykatës në vend shikim, ku paditësi mbi 39- të vite është në posedim të kësaj prone.

Sic u tha edhe më lartë, për gjykatën, kontestues ishte fakti nëse palës paditëse i takon e drejta e pronësisë në ngastrën kontestuese, ku për vërtetimin e këtij fakti, gjykata ka gjetur se pala paditëse në vazhdimësi ka poseduar këtë ngastër për më shumë se 39 vite, e aq më tepër që një gjë e tillë është vërtetuar dhe me deklaratat e dëshmitarëve, e po ashtu edhe me daljen në vend shikim të gjykatës. Sipas nenit 70 të LMTHJP-së” *Posedimin e sendit e ka çdo person që ushtron drejtpërdrejt zotërimin faktik të sendit (posedimi i drejtpërdrejtë).*” Fillimisht, posedimi ishte themeluar me hyrjen në posedim nga paditësi, i cili më pas kishte vazhduar posedimin pa e ndërprerë.

Sa i përket aplikimit të drejtës materiale, apo bazës juridike të kërkesëpadisë, sipas nenit 2.2 të LPK-së, *gjykata nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale, por të njëjtën e çmon sipas çmuarjes së lirë*, e në këtë kuptim ka aplikuar nenin 28 të LMPHJ-së, kurse sa i përket bazës tjetër juridike mbi të cilën është thirrur pala paditëse për vërtetimin e pronësisë në bazë të shitblerjes, nuk e mori të bazuar sepse vendimtare në këtë çështje ka qenë çështja e parashkrimit, kurse baza e shitblerjes nuk ka mundësi që të aplikohet fare, sepse sikur të ekzistonte një punë juridike formale, e njëjta do të implementohej në kadastër, dhe nuk do të kishim fare objekt shqyrtimi këtë çështje.

Gjykata me këtë rast vë theksin se në procedurë kontestimore vendos brenda kufijve të kërkesave të palëve, bazuar në nenin 2.1 të LPK-së *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”* ashtu që nga pala e paditur nuk kishim asnjë kërkesë, por vetëm kundërshtime materiale.

Nga gjendja faktike e vërtetuar, gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, gjë të cilën e vlerësoi si konstatim të drejtë, të ligjshëm dhe që i shërben qëllimit të kontestit, pasi që sipas provave të lartcekura vërtetohet se paditësi ka të drejtën e pronësisë në ngastrën kadastrale, me të dhënat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ku u vërtetua se i njëjti ka blerë këtë ngastër nga pala e paditur, ka përmbushur detyrimet e tij dhe se nga momenti i blerjes së kësaj prone, është futur në posedim të së njëjtës, e të cilën e ka poseduar në mënyrë të pandërprerë dhe të vazhdueshme, ashtu që ka kaluar dhe koha e paraparë ligjore prej 20 viteve, të cilën pronë e ka



të mbajtur me mirëbesim, e ka trajtuar si të vetën, ka ushtruar pushtetin faktik mbi të njëjtën si dhe e ka punuar dhe e punon ende.

Vendimtare në këtë rast për vendosje, ishin deklaratat e dëshmitarëve të proceduar e të cekur si më lartë, të cilët në mënyrë të pa kontestuar i kanë provuar faktet e pretenduara nga paditësi me padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 dhe 463.1 të LPK-së, për faktin se ndër gjyqësorit, nuk i kanë kërkuar shpenzimet e procedurës. Sa i përket shpenzimeve për përfaqësues të përkohshëm, gjykata ka vendosë me aktvendim të veçantë.

Në bazën e të lartshënuarave u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143.1 të LPK-së dhe nenit 20, 28.4, 30 dhe 70 të LMTHPJ-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2022:105924, C.nr.779/22, Dt.02.04.2025

Gjyqtari  
Vegim Maloku

---

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.